




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË KLINËS PËR VITIN 2023

Prishtinë, maj 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Klinës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Klinës (KK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Klinës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Klinës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B1 Komisioni i vlerësimit nuk e kishte bërë vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve sipas kritereve të shpallura me thirrje publike.
- B2 Për pagesat në vlerë prej 189,179€ nuk ishin respektuar hapat për procedim të pagesave.
- B3 Mospagesa e obligimeve brenda afatit ligjor 30 ditë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Klinës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Klinës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Klinës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Klinës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Klinës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keq klasifikim e shpenzimeve, vlerësimi i aplikacioneve të fermerëve në kundërshtim me thirrjen publike, vonesa në pagesën e faturave, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm. Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime, prej tyre dy (2) janë rekomandime të reja, pesë (5) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B1 - Mosvlerësimi i aplikacioneve të fermerëve sipas kriterëve të përcaktuar me thirrje publike

Gjetja

Sipas dy Thirrjeve Publike për subvencionimin e fermerëve me Makina mbjellëse për misër (11,985€) dhe me Makina mbjellëse për grur (12,190€), midis tjerash kërkohej që përfituesi të jetë banor i komunës, të posedojë sipërfaqe të tokës, të këtë traktor, të jetë i gatshëm që të marrë pjesë me 30 % të koston në mekanizëm bujqësor, përparësi do të kenë fermerët të cilët në tri vitet e fundit nuk kanë përfitua ndonjë projekt nga komuna dhe donatorët në bashkëpunim me komunën, të mos jetë përfitues më shumë se një projekt brenda vitit dhe nuk mund të jetë përfitues më shumë se një anëtarë i bashkësisë familjare.

Gjatë shqyrtimit të procesit të vlerësimit të dy thirrjeve publike për subvencionimin e fermerëve me Makina mbjellëse, kemi vërejtur se komisioni i vlerësimit në formularin e poentimit ka përdorë kriterë të cilat nuk kanë qenë të përfshira në asnjërën prej Thirrjeve Publike si: numri i anëtarëve familjar, statusi i punësimit, gjendja ekonomike, ndarja në zonë rurale dhe urbane, posedimi i bunarit.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mosrespektimit të kriterëve të shpalljes publike nga ana e komisionit vlerësues.

Ndikimi

Subvencionimi i fermerëve duke përdorur kriterë të cila nuk kanë qenë të shpallura në thirrje mund ta dëmton transparencën pasi që janë përdorur kriterë që nuk kanë qenë të shpallura në Thirrjet Publike, për të cilat aplikuesit nuk kanë qenë të njoftuar.

Rekomandimi B1

Kryetari duhet të sigurojë se komisioni i vlerësimit do ta bëjë vlerësimin e aplikacioneve të fermerëve në pajtim me kriteret e përcaktuara me Thirrje Publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës Financiare

Gjetja

Neni 22 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit/shërbimit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga 24 mostrat e testuara si pjesë e testimëve substanciale në kategorinë mallra dhe shërbime kemi vërejt se në nëntë (9) raste në vlerë 189,179€, nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht është bërë pranimi i mallit dhe shërbimet/furnizimet dhe fatura pastaj është lëshuar zotimi dhe urdhërblerja.

Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e financave dhe prokurimit pasi që zyrtari zotues dhe zyra e prokurimit nuk i kishin respektuar hapat për procedim të pagesave sipas rregullës financiare.

Ndikimi Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Në katër (4) raste në vlerë 19,997€, kemi vërejtur se komuna nuk i kishte kryer obligimet financiare brenda afatit prej 30 ditësh. Vonesat ishin deri në tre muaj nga data e pranimit të faturës.

Mos pagesa e obligimeve me kohë, ka ndodhur për shkak të hyrjes në obligime financiare pa pasur mjete buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e obligimeve mund t'i shkaktojnë kosto shtesë komunës për shkak se ajo mund të përballlet me padi ku përveç vlerës së faturës duhet t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Klinës në vitin 2023 në total ishin 1,385,801€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave të realizuara nga Komuna të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, Komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte që janë realizuar nga niveli qendror (gjohat e gjykatave dhe dënimet e trafikut) në vlerë totale prej 411,942€.

Çështja C1 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë

Gjetja Ligji Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 12, thekson se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor.

Nga auditimi i të dhënave të tatimit në pronë për vitin 2022, ishin identifikuar 528 tatimpagues të objekteve të cilit në data bazë ju mungonte numri personal të cilët në bazë të emrave, mbiemrave dhe emrit të prindit, mund të jenë potencialisht përfitues të disa hershëm nga zbritja e lejuar ligjore. Nga ky numër për vitin 2023 komuna kishte arritur që 123 tatimpagues t'i identifikonte dhe regjistronte e me numër personal.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e kontrolleve jo të duhura dhe monitorimit të sektorit të tatimit në pronë për të bërë verifikimin e të gjithë tatimpaguesve të objekteve me numrit personal.

Ndikimi Mungesa e të dhënave në data bazë për numrat personal të tatimpaguesve mund të ndikojë në përfitim të paligjshëm të disa hershëm të tatimpaguesve, të zbritjes së lejuar për vendbanim parësor.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2023, ishte 2,017,996€, prej tyre ishin shpenzuar 1,952,127€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzimet për derivate, riparim dhe mirëmbajtje, furnizim me lëndë djegës, komunalitë etj.

Çështja A1 - Mungesa e dokumenteve që ndërlidhen me kërkesat e përshtatshmërisë në platformën elektronike të prokurimit publik

Gjetja Pika 47.16 e Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se “Verifikimi i përshtatshmërisë dhe kualifikimeve të ofertuesve, bëhet përmes Letrës standarde B47 Kërkese për sqarimin e tenderit/aplikacionit përmes platformës elektronike”.

Kemi vërejt se dokumentet e kërkuara sipas kërkesave të përshtatshmërisë për fituesin e kontratës siç janë vërtetimi nga gjykata kompetente, vërtetimi i ATK-së nuk ishin vendosur në platformën elektronike të e-prokurimit. Rastet janë vërejtur te 13 kontrata.

Kjo ka ndodhur, pasi që zyra e prokurimit kishte kërkuar nga fituesit e kontratave që dokumentet në fjalë të dorëzohen në formë origjinale në zyrën e prokurimit në komunë, e jo në platformën elektronike.

Ndikimi Mungesa e dokumenteve të përshtatshmërisë në platformën elektronike ndikon në mosrespektimin e transparencës në procesin e prokurimit dhe në mos marrjen e informatave në mënyrë elektronike nga përdoruesit e lejuar.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të shtojë kontrollet tek zyra e prokurimit për të siguruar se të gjitha dokumentet e kërkuar ngarkohen në platformën elektronike të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit

Gjetja Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Menaxheret e kontratave/ projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar përmes sistemit elektronik të prokurimit publik menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës të kontraktuesve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i kontrolleve jo të duhura nga ana e menaxherëve të projekteve që menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës ta bëjë përmes platformës së e-prokurimit.

Ndikimi Mosmbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo efektiv të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për të

siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2023, ishte 5,652,958€, prej tyre ishin shpenzuar 4,911,241€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me rregullimin e infrastrukturës rrugore, ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimin e objekteve etj.

Çështja B4 - Keqklasifikim i shpenzimeve

Gjetja

Neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se “shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë.

Komuna kishte bërë keq klasifikime të shpenzimeve, ku nga kategoria ekonomike investime kapitale kishte paguar 30,000€, që për nga natyra i takojnë subvencioneve dhe tansferëve. Shpenzimet e paguara kanë të bëjë me furnizim me material ndërtimor për komunitete dhe ndërtimin e shtëpive për raste sociale.

Kjo ka ndodhur si pasojë e planifikimit të gabuar të shpenzimeve gjatë hartimit të buxhetit nga ana e Komunës dhe aprovimit të buxhetit nga Ministria e Financave.

Ndikimi

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ndikon në mbivlerësim/nënvlerësim të shpenzimeve në kategori të ndryshme si dhe prezantim jo të saktë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.4 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2023 ka shpalosur në RVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 3,740,688€.

Çështja B5 - Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja Neni 26 Ligji nr.06/L-005 Për tatimin në pronën e paluajtshme përcakton se Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbareuese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e 10€. Po ashtu në Aktvendimet për ushtrimin e veprimtarisë afariste apo profesionale përcaktohet se pagesa e ngarkesës së caktuar bëhet në dy këste: Kësti i parë bëhet deri më 15.06 të vitit aktual, ndërsa Kësti i dytë bëhet deri më 15.12 të vitit aktual.

Edhe përkundër faktit se gjatë vitit 2023 komuna kishte ndërmarrë veprime për mbledhjen e borxheve duke dërguar njoftime përfundimtar tek borxhlinjtë Llogaritë e arkëtueshme në total krahasuar me vitin paraprak (3,199,211€), janë rritur në 3,740,688€, me diferencë 541,477€ apo rreth 17%. Rritja më e madhe ka ndodhur te tatimi në pronë si dhe tek taksat për ushtrimin e veprimtarisë.

Dobësitë e identifikuara lidhur me llogaritë e arkëtueshme janë për shkak të kontrolleve të brendshme jo efikase në menaxhimin përkatësisht arkëtimin e tyre.

Ndikimi Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin komunal dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve nga të hyrat vetanake.

Rekomandimi B5 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se zyrtarët në departamentet përkatëse do të intensifikojnë veprimet dhe ndërmarrin të gjitha masat për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe zvogëlimin e trendit të tyre rritës ndër vite.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	13,051,595	15,568,207	14,691,283	11,547,857	11,134,682
Grante Qeveritare - Buxheti	11,677,821	12,337,344	12,048,247	9,910,436	10,065,557
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	97,023	23,911
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,322,988	1,227,234	850,471	482,004
Të hyrat vetanake	1,373,774	1,373,774	951,375	663,127	542,080
Donacionet vendore	0	104,122	37,023	21,362	16,130
Donacionet e jashtme	0	429,979	427,403	5,438	5,000

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,516,612€. Kjo rritje është rezultat i Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, si dhe donacioneve.

Komuna ka shpenzuar rreth 94% të buxhetit final e cila paraqet një performancë të mirë buxhetore.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	13,051,595	15,568,207	14,691,283	11,547,857	11,134,682
Pagat dhe mëditjet	6,753,688	7,416,450	7,406,952	6,441,464	6,700,218
Mallrat dhe shërbimet	1,660,000	1,782,812	1,716,951	1,340,624	1,211,429
Komunalitë	200,000	235,184	235,176	166,972	179,399
Subvencionet dhe transferet	400,000	480,803	420,963	401,429	345,109
Investimet Kapitale	4,037,907	5,652,958	4,911,241	3,197,368	2,698,527

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:
 Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 662,763€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës në vlerë 659,524€ për realizimin e ligjit të ri të pagave, si dhe rritje prej 3,239€, nga granditë e donatorëve.
 Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 122,812€. Kjo rritje ishte nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2022.
 Buxheti final për komunalitet ishte rritur për 35,184€. Kjo rritje është bërë nga të hyrat vetanake të bartura për mbulimin e obligimeve të pashlyera.
 Buxheti final për subvencione ishte rritur për 80,803€, nga kjo vlerë: 55,884€, ishte rritje nga donacionet e brendshme (participimet e qytetarëve) si dhe rritje prej 24,919€, nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2022.
 Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,615,051€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga vitin 2022 për 1,140,073€, dhe rritje nga donacionet për 474,978€.

Mjetet e shpenzuara në vitin 2023, për Rimëkëmbjen Ekonomike ishin 8,172€, ato kryesisht ishin ndarë për shtesa në shëndetësi.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2023, ishin 1,373,774€, përderisa ishin realizuar 1,385,801€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2023, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 411,942€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	1,373,774	1,373,774	1,385,801	1,208,535	1,365,338
Të hyrat tatimore	603,604	603,604	621,791	453,281	488,481
Të hyrat jo tatimore	770,170	770,170	764,010	755,254	876,857

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022, kishte rezultuar me 12 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2022 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, një (1) ishte zbatuar pjesërisht, një (1) është i mbyllur dhe pesë (5) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të siguroj se regjistri i pasurive është azhurnuar në mënyrë që i njëjti të përmban vetëm pasuritë në pronësi të komunës. Po ashtu, të siguroj se vlera e pasurisë e prezantuar në PFV-të e komunës është e saktë.	Komuna kishte ndërmarr veprime dhe i kishte larguar pasurit nga regjistri komunal duke i bartur tek përfituesit.	I zbatuar

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se para se të bëhen shpalljet e thirrjeve publike për subvencionim të fermerëve, të bëhet një analizë e mirëfilltë e kriterëve në mënyrë që ato të shpallen dhe Komisionet e Vlerësimit të vlerësojnë aplikacionet me përpikëri të plotë kundrejt tyre.	Edhe në vitin 2023, kishte raste kur komisioni i vlerësimit të aplikacioneve të fermerëve gjatë vlerësimit kishte ndryshuar kriteret e vlerësimit. Kriteret e vendosura nga komisioni nuk ishin sikurse kriteret e parapara në thirrje publike.	Nuk ka filluar zbatim
3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.	Kemi identifikuar raste të njëjta sikurse vitin e kaluar.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Të hyrat	Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.	Rekomandimi është zbatuar pjesërisht dhe se ende vazhdojnë mangësitë për numrat personal të tatimpaguesve në sistemin protax.	Pjesërisht i zbatuar
5.	Subvencionet dhe transferet	Kryetari duhet të shtojë kontrollet për të siguruar se zyrtarët të cilët janë përfshirë në proceset e dhënies së subvencioneve të jenë të informuar mirë në lidhje me kërkesat e Rregullores, në mënyrë që të mos përsëriten lëshimet e sipërpërmendura dhe të aplikohet me përpikëri të plotë.	Komuna ka ndërmarrë masa sa i përket respektimit të kriterëve të Thirrjes Publike, dhe nuk kemi hasur në ndonjë çështje për tu raportuar.	I zbatuar
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël.	Edhe gjatë vitit 2023, ishin bërë keqklasifikim i shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatim
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e emërimit të menaxherëve të kontratave, menjëherë pas nënshkrimit të kontratave, të nënshkruhet plani për menaxhimin e kontratave nga të dyja palët, në pajtim me kërkesat ligjore.	Nga testimi i mostrave tona ka dal se për gjitha kontratat ka plan të menaxhimit të kontratave.	I zbatuar

8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se drejtoritë përkatëse para nënshkrimit të kontratës të dakordohen në lidhje me vendosjen e planit dinamik të përfundimit të punëve, në mënyrë që të mos ketë vonesa.	Në mostrat tona nuk kemi hasur ndonjë çështje.	I zbatuar
9.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që janë rishikuar regjistrat e pasurive në mënyrë që të evidentohen të gjitha pasuritë që janë të regjistruara si Investime në vijim e që janë të finalizuar si projekte dhe të pranuar teknikisht. Po ashtu, të bëhen ndryshimet në regjistrin kontabël, në mënyrë që atyre pasurive tu ndryshohet klasa dhe të aplikohet zhvlerësimi sipas normave të përcaktuara me rregullore.	Komuna ka zbatuar rekomandimin duke i regjistruar pasurit sipas kërkesave ligjore.	I zbatuar
10.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët të ndërmarrin veprime për plotësimin e lëndëve të borxhlinjve, në mënyrë që të ketë dëshmi që ofrojnë siguri se shumatat e paraqitura të LLA janë të sakta.	Kuvendi Komunal kishte marr vendim për faljen e këtyre të arkëtueshmeve.	Nuk është i aplikueshëm më
11.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se zyrtarët në departamentet përkatëse do të intensifikojnë veprimet dhe ndërmarrin të gjitha masat për mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe zvogëlimin e trendit të tyre rritës ndër vite.	Edhe pse entiteti kishte ndërmarrë veprime për mbledhjen e të arkëtueshmeve, gjatë vitit 2023 kishte vazhduar trendi në rritje për LL/A.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha faturat dhe obligimet të paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i komunës me kosto shtesë të përmbarimit.	Nuk janë ndërmarr veprimet e nevojshme për adresimin e këtij rekomandimi.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-klina.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Klinës, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Zenun Elezaj,

Kryetar i Komunës së Klinës,

Data: 14.4.2024 Klina



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.